



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT**

V E N D I M

Nr. 51, datë 28.05.2025

PËR

**MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:
“NDËRTIMI I IMPIATIT GJENERUES TË ENERGJISË FOTOVOLTAIKE ME
KAPACITET TË INSTALUAR 30MW DHE VEPRAVE NDIHMËSE”, ME
VENDNDODHJE NË DËRMËNAS, BASHKIA FIER**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Ndërtimi i impiatit gjenerues të energjisë fotovoltaike me kapacitet të instaluar 30MW dhe veprave ndihmëse”, me vendndodhje në Dërmënas, Bashkia Fier, me subjekt zhvillues shoqërinë “EZ-5 ENERGY”sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit, hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHYLLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 05/11 / 2025